



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



DREJTORIA E BUJQËSISË

THIRRJE PËR APLIKIM

PËRKRAHJA E FERMERËVE - VIÇA PËR MAJMËRI 2022

Duke u bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, nr.14-400/04-223306/22, të datës, 14.10.2022, ftojme fermerët e komunës së Prishtinës të aplikojnë për subvencione, pagesa direkte, për prodhim të mishit, 2022.

Fermerët që do të përkrahen duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Të jenë banorë të komunës së Prishtinës dhe aktivitetin e tyre prodhues ta realizojnë në territorin e komunës së Prishtinës;
- Mosha e viçave duhet të jetë nga 6-16 muaj;
- Të kenë 3-10 krerë viça;
- Viçat për majmëri të jenë të matrikuluar me matriculë të Republikës së Kosovës;
- Viçat për majmëri të jenë të identifikuar dhe regjistruar në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Të dhënat për viçat për majmëri në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jenë të përditësuar;
- Subvencionimi do bëhet për krerë/viça për majmëri.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare;
- Regjistri për vitin 2022, i lëshuar nga praktikat veterinarë të kontraktuara nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve në AUV.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

Data e aplikimit, prej 18.10.2022 deri më 31.10.2022

